Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/227
Datë: 07.06.2021

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë nr. 09/2019, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 31.05.2021 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Akreditohet** "Qendra për Aftësim Profesional" - Mitrovicë me adresë, Rr. "Driton Veliu" Mitrovicë, Kosovë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 31.05.2021 deri 30.05.2024, për zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP), me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   1.1 **Saldim**, Niveli III sipas KKK me 40 kredi të AAP. IAAP mund të përfshijë në procesin e NjMP deri 2 kandidatë brenda një muaji.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së "Qendrës për Aftësim Profesional" në Mitrovicë për akreditim të zbatimit të NjMP dhe rekomandimeve të dala nga Raporti vlerësues i ekipit të ekspertëve për akreditim të institucioneve për zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP), u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për Akreditim të zbatimit të NjMP si institucion; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin

ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë nr. 09/2019. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Qendrës për Aftësim Profesional – Mitrovicë;
2. Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetari i KD së AKK